

VENDIM
Nr.1145, datë 5.8.2008

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR.455, DATË 16.4.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KALIMIN E SIPËRFAQES 6800 (GJASHTË MIJË E TETËQIND) M², PRONË SHITETËRORE, NË PRONËSI TË KOMUNAVE FAN E OROSH DHE TË BASHKIVE RUBIK E RRËSHEN”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.455, datë 16.4.2008 të Këshillit të Ministrave bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në titull dhe në pikën 1 sipërfaqja prej “6800 (gjashtë mijë e tetëqind) m²” bëhet “7300 (shtatë mijë e treqind) m²”.

b) Në listën, që i bashkëlidhet vendimit, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

i) Numrave rendorë 3 e 4, për pronësitë nr.81/17 dhe nr.81/18, u ndryshon vendndodhja nga “Thirrë” në “Shtrungaj”.

ii) Pas numrit rendor 16 shtohet numri 16.1, me këtë përmbajtje:

16.1	13/ 2	500	324	Rub		Sht
		250	4	ik	Rub	et
		0			ik	

2. Procedurat për kalimin në pronësi të bashkisë Rubik të sipërfaqes 500 (pesëqind) m², të shtuar me këtë vendim, të përfundojë brenda 5 (pesë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, bashkia Rublik dhe zyra rajonale e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Mirditë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha